



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

R A P O R T

PËR VETEVALUIMIN E FAKULTETIT FILOLOGJIK

Tetovë, 10.04.2023

Fakulteti Filologjik-Филолошки факултет-Faculty of Philology
Str. Ilinden, nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: philology@unite.edu.mk

Përmbajtja:

1. Qëllimi i procesit të vetevaluimit.....	3
2. Përshkrimi i Fakultetit.....	3
2.1. Historiku.....	3
2.2. Misioni	4
2.3. Strategjia e zhvillimit	4
3. Struktura organizative e Fakultetit.....	4
3.1. Organogrami.....	4
3.2. Programet studimore	5
4. Veprimtaria mësimore	8
5. Struktura e kuadrit mësimor.....	9
6. Struktura e studentëve.....	12
6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike	12
6.2. Struktura e studentëve në studimet pasdiplomike (master).....	14
7. Realizimi i orës mësimore në programet studimore të Fakultetit Filologjik	16
8. Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte.....	22
9. Hapësirat dhe resurset materiale	24
10. SWOT Analiza.....	25
11. Konkludimi	26

1. Qëllimi i procesit të vetevaluimit

Qëllimi fillestar i realizimit të vetevaluimit qëndron në ngritjen e nivelit arsimor-shkencor të fakultetit Filologjik në përgjithësi dhe reflektimin e të arriturave të stafit akademik dhe studentëve në veçanti. Më konkretisht, ky evaluim do të nxjerr në dritë të arriturat e Fakultetit Filologjik që kanë rezultuar të suksesshme dhe disa të arritura në aspekte të tjera akademike që priten të realizohen në të ardhmen e afërt. Pra, me realizimin e vetevaluimit del në pah pasqyra reale e të arriturave në aspektin mësimor-shkencor, nëpërmjet analizës së strukturës dhe nivelit të mësimdhënësve dhe trajtimi i nevojave të mundshme arsimore për ngritjen profesionale të studentëve. Poashtu, në fokus është edhe analiza e programeve studimore të këtij fakulteti, me qëllim përcaktimi të lëndëve që përkojnë me objektivin studimor dhe lëndëve që nuk përkojnë ose përkojnë në mënyrë të pjesërishme. Kjo formë e evaluimit nxit edhe mëtej rrugën e ngritjes dhe shtimit të kuadrit profesional të fakultetit, me të gjitha programet përkatëse studimore, të cilat po ndryshohen dhe përshtaten sipas trendeve të fundit të arsimit sipërorë dhe shkojnë në përputhshmëri me kërkesat dhe nevojat e studentëve.

2. Përshkrimi i Fakultetit

2.1. Historiku

Fakulteti Filologjik, si njësi akademike e Universitetit të Tetovës, është themeluar që me themelimin e vetë Universitetit, në vitin 1994. Në kuadër të Fakultetit Filologjik, që nga themelimi i tij, kanë funksionuar këto katedra: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze, Gjuhë dhe Letërsi Gjermane. Me zyrtarizimin e Universitetit të Tetovës në vitin 2004, programet studimore Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze, Gjuhë dhe Letërsi Gjermane bëhen pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, në vitin 2004 hapet edhe programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Maqedonase. Me përshtatjen e programeve studimore sipas sistemit të Bolonjës dhe me akreditimin e vitit 2007, përsëri formohet Fakulteti Filologjik, por përveç katër programeve studimore, që funksionin shtohen edhe programet studimore Gjuhë dhe Letërsi Frënge dhe Gjuhë dhe Letërsi Italiane.

2.2. Misioni

Misioni i Fakultetit Filologjik është përgatitja e mësimeve të ardhshme të gjuhës amtare si gjuhës shqipe dhe maqedonase, pastaj edhe mësimeve të gjuhëve të huaja si angleze, gjermane, frënge dhe italiane. Programet studimore janë konform standardeve botërore për përgatitjen e kuadrit të kualifikuar dhe sa më cilësor në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

2.3. Strategjia e zhvillimit

Në planin strategjik, Fakulteti Filologjik bën përpjekje për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së mësimit dhe mbajtjen e ritmit me universitetet e dëshmuara, duke u munduar që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës. Një ndër synimet kryesore është realizimi i qëllimeve të vendosura që Fakulteti Filologjik të jetë në ndihmën e ngritjes së cilësisë së mësimit dhe mësimit, plotësimin e kërkesave të studentëve, duke i ndjekur trendet bashkëkohore të zhvillimit të mësimit të gjuhës amtare dhe gjuhëve të huaja.


3. Struktura organizative e Fakultetit

3.1. Organogrami

Organi më i lartë në Fakultetin Filologjik është dekani, i ndjekur nga dy prodekanët: prodekani për arsim dhe prodekani për shkencë. Dekani merret me pjesët organizative të fakultetit, kurse dy prodekanët asistojnë në kryerjen e detyrave të ndryshme, bazuar në sferën e caktuar.

Drejtoria e dekanatit përbëhet nga dekani, prodekanët, koordinatori për ECTS, koordinatori për master, koordinatori për doktoratë dhe shefat e programeve studimore. Pjesë e rëndësishme e stafit të dekanatit është dhe sekretari i fakultetit që merret me detyrat e sferës juridike.

Secili program studimor udhëhiqet nga një mësues nga katedra përkatëse. Të gjithë shefat e programeve studimore janë në bashkëpunim të ngushtë me drejtorinë e dekanatit. Për detyrat e tyre, ata i raportojnë dekanit dhe prodekanëve për çështjet e ndryshme të programit përkatës të studimit.



Fotografia 1. Organogrami i Fakulteti Filologjik.

3.2. Programet studimore

Në Fakultetin Filologjik ekzistojnë gjashtë programe studimore. Planprogramet janë organizuar konform prioriteteve kombëtare, tregut të punës dhe programeve studimore në rajon. Sipas deskriptorëve, të gjitha programet studimore janë konform syllabuseve dhe në përputhshmëri me rregulloren e kornizës kombëtare për kualifikimet në arsimin e lartë. Fakulteti Filologjik është i përfshirë në një projekt të organizuar nga Zyra për Menaxhimin e Cilësisë dhe Evaluimit, në përpjekje të analizës së programeve studimore. Konkretisht, analiza ishte e orientuar në identifikim të përputhshmërisë së qëllimeve të lëndëve me deskriptorët e programeve përkatëse, në përputhshmëri me Rregulloren e Kornizës Kombëtare për Kualifikim në arsimin e lartë dhe tregun e punës etj.

Tabela 1. Programet studimore në kuadër të Fakultetit Filologjik.

Nr.	Programi studimor	Viti i themelimit
1.	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	1994
2.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	1994
3.	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	1994
4.	Gjuhë dhe Letërsi Maqedonase	2004
5.	Gjuhë dhe Letërsi Frënge	2008
6.	Gjuhë dhe Letërsi Italiane	2011

Analiza e programeve studimore të Fakultetit Filologjik:

Programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

- Analiza e programit studimor aktual Gjuhë dhe Letërsi Shqipe tregon se pjesa dërmuese e lëndëve janë të fushës së programit studimor. Me përjashtim 17% (lëndë zgjedhore) pjesërisht i takojnë fushës së gjuhës dhe letërsisë shqipe.
- Në bazë të vlerësimit të syllabuseve, 92% e lëndëve obligative dhe zgjedhore plotësisht dhe ose pjesërisht janë të orientuara të zhvillojnë kompetenca të studentëve sipas deskriptorëve të programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.
- Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit shkencore, përmbajtjen si dhe literaturën e ofruar, të gjitha lëndët kanë nevojë të pjesërishtme për azhurnim.

Programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze

- Të gjitha lëndët e programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze, pa përjashtim, janë vlerësuar se kanë të definuara qëllime që janë në përputhshmëri me kompetencat e parapara në deskriptorët që duhet të zhvillohen te studentët.
- Prej gjithsej 78 lëndë obligative dhe zgjedhore që e përbëjnë strukturën e programit studimor, 91% prej tyre sipas vendosjes kronologjike ndihmojnë në mbindërtimin e njohurive të studentëve.
- Statusi i lëndëve të programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze është vlerësuar se duhet të ndryshojë plotësisht për gjashtë lëndë zgjedhore, kurse pjesërisht është e nevojshme edhe ndryshimi i statusit të dy lëndëve obligative.

Programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

- Në programin studimor aktual Gjuhë dhe Letërsi Gjermane pjesa dërmuese e lëndëve janë pjesë e fushës së gjuhës dhe letërsisë gjermane.
- Bazuar në syllabuse, rreth 90% e lëndëve obligative dhe zgjedhore plotësisht/pjesërisht nxisin shkathtësitë e studentëve të aplikueshme në tregun e punës.

Programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Maqedonase

- Në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Maqedonase pjesa dërmuese e lëndëve obligative kryesisht i përkasin fushës së programit përkatës sipas Klasifikimit të Fraskatit.
- Marrë në tërësi, lëndët në programin studimor janë të shpërndara në semestra me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin dhe mbindërtimin e njohurive të studentëve. Më konkretisht, prej lëndëve obligative, pesë prej tyre pjesërisht janë vendosur në semestrin e duhur dhe vështirësojnë mbindërtimin e njohurive.
- Statusi i lëndëve të programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Maqedonase është vlerësuar se duhet të ndryshojë plotësisht për gjashtë lëndë, kurse pjesërisht për dy lëndë zgjedhore.

Programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Frënge

- Në kuadër të programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Frënge, rreth 79% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas klasifikimit ndërkombëtar të Fraskatit.
- Të gjitha lëndët obligative dhe zgjedhore kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave, në përjashtim të një lënde zgjedhore që kontribuon në mënyrë të pjesshme në zhvillimin e kompetencave.
- Aktivitetet e planifikuara që duhet t'i realizojnë studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse në të gjitha lëndët (70% nga lëndët obligative dhe zgjedhore) janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse.
- Duke marrë parasysh zhvillimet dhe avancimet e fundit shkencore në fushën e letërsisë si dhe përmbajtjen dhe literaturën e ofruar, rreth 50% e lëndëve obligative dhe zgjedhore kanë nevojë që gjatë akreditimit të ardhshëm të azhurnohen me qëllim të plotësimin të

kërkesave bashkëkohore në përputhje me arritjet dhe avancimet në fushën e gjuhës dhe letërsisë frënge.

Programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Italiane

- Në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Italiane, prej gjithsej 44 lëndëve obligative, rreth 80% prej tyre janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas klasifikimit ndërkombëtar të Fraskatit si dhe katër lëndë¹ janë pjesërisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor.
- Të gjitha lëndët obligative dhe zgjedhore kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave të studentëve në përputhshmëri me deskriptorët e programit, në përjashtim të një lënde obligative që në mënyrë të pjesshme kontribuon në zhvillimin e tyre.
- Aktivitetet e planifikuara që duhet t'i realizojnë studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse në të gjitha lëndët (konkretisht 74% të lëndëve obligative dhe zgjedhore) janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse.
- Duke marrë parasysh zhvillimet dhe avancimet e fundit shkencore, ku përket programi si dhe përmbajtjen dhe literaturën e ofruar, rreth 50% e lëndëve obligative dhe zgjedhore kanë nevojë që gjatë akreditimit të ardhshëm të azhurnohen, me qëllim të plotësimit të kërkesave në përputhje me zhvillimet dhe avancimet në fushën e gjuhës dhe letërsisë italiane.

4. Veprimtaria mësimore

Lidhur me veprimtarinë mësimore, në Fakultetin Filologjik mësimi zhvillohet në mënyrë të kombinuar, pra tradicionale dhe bashkëkohore. Mësimdhënësit punojnë në mënyrë që të zhvillojnë mësim interaktiv, por duke mos lënë anash edhe mësimdhënien tradicionale pra, qasjen frontale të ligjërimit. Ndryshe thënë, qëllimi kyç i mësimdhënësve është që metodat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe nxënies të implementohen me shumë përkushtim, me qëllim që studentëve t'ju jepet hapësirë e mjaftueshme për të dëshmuar aftësitë e tyre gjuhësore dhe shkencore.

¹ Lëndët për gjitha programet studimore janë të njohura për komisionin për evaluim të njësisë akademike.

Shkathësitë, njohuritë dhe vlerat e studentëve maten dhe vlerësohen ose testohen në vazhdimësi duke shfrytëzuar metoda dhe teknika të të mësuarit, me qëllim të përvetësimit të drejtë të njohurive profesionale. Në vazhdim, për të arritur deri te nota përfundimtare, studentëve ju kërkohet që të bëjnë punime seminarike, prezantime, hulumtime të vogla në grupe apo çifte, si dhe dy kolokuiume. Këtu vlejnë të përmenden edhe disa aspekte që e pengojnë zhvillimin e mësimin interaktiv. Një prej tyre është mungesa e pajisjeve elektronike dhe qasja në internet të shpejtë në të gjithë klasat si: kompjuterët, printerët, fotokopjet, projektorët, etj., që gjithsesi ndikojnë në zhvillimin e mësimin interaktiv.

Studentët kanë lëndë të obligueshme, të cilat duhet patjetër t'i ndjekin. Kanë edhe lëndë me zgjedhje (katër lëndë zgjedhore, prej të cilave ata zgjedhin dy lëndë). Pjesë e lëndëve janë dhe lëndët opcionale, të cilat janë lëndë nga fakultetet tjera. Të gjitha këto kanë numrin e caktuar të kredive, të cilat në raste mobiliteti mund t'i bartin në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Në vitin e fundit akademik, të gjithë studentët e kanë të obligueshme që të realizojnë mësimin praktik për një muaj nëpër shkolla të ndryshme fillore dhe të mesme në Tetovë dhe rrethinë, me marrëveshje mes profesorëve universitar dhe mësimdhënësve nëpër shkollat përkatëse nikoqire.

Vlen të përmendet edhe sfida me të cilën u përballëm gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, ku dy semestra rradhazi procesi mësimor u realizua online, nëpërmjet platformës MEET. Si proces ka qenë shumë sfidues, pasi ishte diçka e re, por kaloi me sukses duke i pasur në konsideratë kufizimet që na i diktonte pandemia. Me këtë u konfirmua që Universiteti ynë, edhe pse me shumë studentë, arriti që ta menaxhojë mbarëvajtjen e procesit mësimor, duke përfshirë edhe vlerësimin e studentëve në provime.

5. Struktura e kuadrit mësimor

Nga tabelat e mëposhtme shohim se numri më i madh i kuadrit mësimor është i rregullt për dallim nga mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët me kontratë, për vitin akademik 2019/20 numrin i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve të rregullt shkon në 43 ndërsa, të të angazhuarve me kontratë shkon në 40. Për vitin akademik 2020/21, numri i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve të rregullt shkon në 44 ndërsa, të të angazhuarve me kontratë shkon në 36. Në vazhdim, për vitin akademik 2021/22, numrin i të angazhuarve të rregullt bie në 43 ndërsa e të angazhuarve me

kontratë qëndron e njejtë (36). Duke i pasur parasysh këto të dhëna dhe duke bërë një krahasim, mund të përfundojmë që numri i të angazhuarve të rregullt dhe të atyre me kontratë është i përafërt për vitin akademik 2019/20 pra, 43 me 40; për vitin akademik 2020/21 dhe 2021/22 dallimin është më i dukshëm dhe shkon në 44 me 36 dhe 43 me 36.

Mosha mesatare e mësimitdhënësve është 40-55 për vitet akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022. Gjatë kësaj periudhe 3 profesorë dolën në pensionim. Ndërsa mosha mesatare e bashkëpunëtorëve është 35-42 për vitet akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022. Për më tepër, çdo vit angazhohen asistentë të rinj, të cilët janë studentë ekselentë të Fakultetit Filologjik me mesatare mbi 9.5 e më lartë.

Në aspektin gjinor, mund të themi se ekziston një balancë, duke u bazuar në numrat e paraqitur në tabelat e këtyre tre viteve. Normalisht nuk mund përqindjet të jenë të prera me saktësi, por fatmirësisht, nuk ekziston ndonjë diskrepancë e skajshme në mes meshkujve dhe femrave të punësuar në Fakultetin Filologjik. Mund të thuhet që numri i të punësuarve femra është më i lartë në krahasim me meshkujt e punësuar në këtë fakultet. Pra, në vitin akademik 2019/20, numri i të punësuarve femra shkon në 47 me 36 meshkuj të punësuar; për vitin akademik 2020/21 shkon në 44 me 36 dhe për vitin akademik 2021/22 shkon në 41 me 38.

Tabela 2. Struktura e mësimitdhënësve sipas thirrjeve mësimore-shkencore dhe gjinisë në vitin akademik 2019/2020.

MËSIMDHËNËS							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Ordinar	3	1	4	Ordinar	3	6	9
Inordinar	7	6	13	Inordinar	1	/	1
Docent	9	9	18	Docent	2	3	5
Gjithsej	19	16	35	Gjithsej	6	9	15

Tabela 3. Struktura e bashkëpunëtorëve sipas thirrjeve mësimore-shkencore dhe gjinisë në vitin akademik 2019/2020.

BASHKËPUNËTORË							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Asistent doktorant	/	2	2	Asistent	8	15	23
Asistent	2	3	5	Demonstratorë	1	1	2
Lektor	/	1	1				
Gjithsej	2	6	8	Gjithsej	9	16	25

Tabela 4. Struktura e mësimdhënësve sipas thirrjeve mësimore-shkencore dhe gjinisë në vitin akademik 2020/2021

MËSIMDHËNËS							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Ordinar	3	2	5	Ordinar	3	5	8
Inordinar	8	6	14	Inordinar	2	/	2
Docent	8	10	18	Docent	1	1	2
Gjithsej	19	18	37	Gjithsej	6	6	12

Tabela 5. Struktura e bashkëpunëtorëve sipas thirrjeve mësimore-shkencore dhe gjinisë në vitin akademik 2020/2021.

BASHKËPUNËTORË							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Asistent doktorant	/	2	2	Asistent	8	14	22
Asistent	2	2	4	Demonstratorë	1	1	2
Lektor	/	1	1				
Gjithsej	2	5	7	Gjithsej	9	15	24

Tabela 6. Struktura e mësimdhënësve sipas thirrjeve mësimore-shkencore dhe gjinisë në vitin akademik 2021/2022.

MËSIMDHËNËS							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Ordinar	3	2	5	Ordinar	3	5	8
Inordinar	11	8	19	Inordinar	2	/	2
Docent	5	7	12	Docent	1	1	2
Gjithsej	19	17	36	Gjithsej	6	6	12

Tabela 7. Struktura e bashkëpunëtorëve sipas thirrjeve mësimore-shkencore dhe gjinisë në vitin akademik 2021/2022.

BASHKËPUNËTORË							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Asistent doktorant	/	2	2	Asistent	8	12	20
Asistent	3	1	4	Demonstratorë	2	2	4
Lektor	/	1	1				
Gjithsej	3	4	7	Gjithsej	10	14	24

6. Struktura e studentëve

6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

Trendi i numrit të studentëve në vitet paraprake ka qenë në rritje, por për vitet akademike që janë pjesë e këtij raporti, siç e shohim në tabelat e mëposhtme, është në rënie. Rënia e numrit të studentëve varet nga shumë faktorë, si nataliteti, shpërngulja, etj.

Tabela 8. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2019/2020.

Nr.	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Projekt 35/45	Gjithsej	Shtetas të huaj	Nacionaliteti
1.	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	9	1	/	10	1	/
2.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	21	16	/	38	4	1
3.	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	35	9	/	44	11	/
4.	Gjuhë dhe Letërsi Maqedonase	7	4	/	11	/	1
5.	Gjuhë dhe Letërsi Frënge	4	3	/	7	1	/
6.	Gjuhë dhe Letërsi Italiane	/	/	/	/	/	/
Gjithsej		76	33	/	110	17	2

Tabela 9. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2020/2021.

Nr.	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Projekt 35/45	Gjithsej	Shtetas të huaj	Nacionaliteti
1.	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	7	4	/	11	4	/
2.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	30	12	/	42	7	/
3.	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	23	12	/	35	4	/
4.	Gjuhë dhe Letërsi Maqedonase	3	3	/	6	/	/
5.	Gjuhë dhe Letërsi Frënge	/	/	/	/	/	/
6.	Gjuhë dhe Letërsi Italiane	/	/	/	/	/	/
Gjithsej		63	31	/	94	15	/

Tabela 10. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2021/2022.

Nr.	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Projekt 35/45	Gjithsej	Shtetas të huaj	Nacionaliteti
1.	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	3	5	/	8	1	/
2.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	22	10	/	35	8	/
3.	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	22	4	/	26	6	1
4.	Gjuhë dhe Letërsi Maqedonase	2	2	/	4	/	/
5.	Gjuhë dhe Letërsi Frënge	/	3	/	3	/	/
6.	Gjuhë dhe Letërsi Italiane	/	/	/	/	/	/
Gjithsej		49	24	/	76	15	1

6.2. Struktura e studentëve në studimet pasdiplomike (master)

Në Fakultetin Filologjik janë të akredituar 10 drejtime në kuadër të 5 programeve studimore, edhe atë: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe, Gjuhë angleze, Letërsi angleze, Metodika e mësimdhënies së gjuhës angleze, Gjuhë gjermane, Gjuhë maqedonase, Letërsi Maqedone, Gjuhë frënge dhe Letërsi frënge. Çdo vit akademik kemi një ulje relative të numrit të studentëve, të cilët regjistrohen në studimet pasdiplomike në Fakultetin Filologjik.

Tabela 11. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2019/2020.

Nr.	Programi studimor	Numri i studentëve
1.	Gjuhë shqipe	3
2.	Letërsi shqipe	9
3.	Gjuhë angleze	2
4.	Letërsi angleze	2
5.	Metodika e mësimdhënies së gjuhës angleze	4
6.	Gjuhë gjermane	6

7.	Gjuhë maqedonase	/
8.	Letërsi maqedonase	/
9.	Gjuhë frënge	/
10.	Letërsi frënge	/
	Gjithsej	26

Tabela 12. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2020/2021.

Nr.	Programi studimor	Numri i studentëve
1.	Gjuhë shqipe	8
2.	Letërsi shqipe	5
3.	Gjuhë angleze	4
4.	Letërsi angleze	/
5.	Metodika e mësimdhënies së gjuhës angleze	7
6.	Gjuhë gjermane	1
7.	Gjuhë maqedonase	/
8.	Letërsi maqedonase	/
9.	Gjuhë frënge	/
10.	Letërsi frënge	/
	Gjithsej	25


Tabela 13. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2021/2022.

Nr.	Programi studimor	Numri i studentëve
1.	Gjuhë shqipe	3
2.	Letërsi shqipe	6
3.	Gjuhë angleze	2
4.	Letërsi angleze	1
5.	Metodika e mësimdhënies së gjuhës angleze	6
6.	Gjuhë gjermane	1
7.	Gjuhë maqedonase	1
8.	Letërsi maqedonase	/
9.	Gjuhë frënge	/
10.	Letërsi frënge	/
	Gjithsej	20

7. Realizimi i orës mësimore në programet studimore të Fakultetit Filologjik


Studentët e Fakulteti Filologjik kanë dhënë vlerësim mbi procesin mësimor të realizuar gjatë periudhës akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022. Ata janë përgjigjur në pyetësorë online për procesin e mbarëvajtjes dhe cilësisë së procesit mësimor, edhe atë veçmas për ligjërata dhe veçmas për ushtrime. Në çdo pyetje studentët janë përgjigjur se sa pajtohen nëse një dukuri e caktuar ka qenë prezente gjatë procesit mësimor, në shkallë prej 1, që nënkupton që dukuria e caktuar nuk ka qenë aspak prezente, deri në 5 ku dukuria e caktuar ka qenë plotësisht prezente.

Studentët e Fakultetit Filologjik në nivel të përgjithshëm të fakultetit gjithsej kanë dhënë 400 vlerësime, duke përfshirë gjithë vitet studimore. Në kuadër të këtij vlerësimi në të gjithë indikatorët studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e procesit mësimor. Studentët të cilët i janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjëruar (M = 4.39). Si vijim, studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, niveli i informimit për realizimin e lëndëve gjatë ligjëratave është i lartë (M=4.46), gjatë ushtrimeve ky nivel shënon një tendencë uljeje krahasuar me orët e ligjëratave por sërish vlerësohet si pozitiv (M=4.38), fillimi dhe përfundimi i ligjëratave (M=4.52) dhe ushtrimeve (M=4.45) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 1). Lidhshmëria e materialit për përdorim praktik, gjatë orëve të ligjëratave është vlerësuar pozitivisht me (M=4.36) kurse gjatë orëve të ushtrimeve është vlerësuar me (M=4.29). Mësimdhënësit gjatë orëve të ligjëratave kanë qenë të qartë lidhur me materialin e prezantuar (M=4.39), gjatë ushtrimeve niveli i qartësisë është shprehur me (M=4.31).




Grafikoni 1. Vlerësimi i procesit mësimor në Fakultetin Filologjik

Në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze, gjithsej janë dhënë 201 vlerësime. Studentët të cilët i janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, pajtohen se testimi në lëndët e evaluara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjëruar (M=4.31). Studentët kanë vlerësuar se gjatë ligjëratave janë të informuar në lidhje me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës, (M=4.46), gjatë ushtrimeve niveli i informimit është pozitiv (M=4.43), se ligjëratat dhe ushtrimet janë të qarta (M=4.37) dhe se ka lidhshmëri të përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive si në ligjërata edhe në ushtrime, (M=4.32). Studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave (M = 4.46) dhe ushtrimeve (M = 4.43) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 2).




Grafikoni 2. Vlerësimi i procesit mësimor në Programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze

Në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Frënge, gjithsej janë dhënë 25 vlerësime. Studentët të cilët i janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, pajtohen se testimi në lëndët e evaluara është realizuar mesatarisht mire nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M=3.83$). Studentët kanë dhënë vlerësim mesatar pozitiv për nivelin e informimit gjatë ligjëratave lidhur me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës ($M=3.38$), kurse gjatë ushtrimeve niveli i informimit paraqet një tendencë të rritjes ($M=3.56$). Vlerësim mesatar pozitiv është shprehur edhe për qartësinë e mësimdhënësve në ligjërata dhe ushtrime, ($M=3.56$), ($M=3.60$); lidhshmëria e përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive gjatë ligjëratave është mesatar pozitiv ($M=3.76$), kurse gjatë ushtrimeve paraqet një tendencë të uljes ($M=3.62$). Studentët pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave dhe ushtrimeve ($M=3.38$); ($M=3.56$) realizohet mesatarisht saktë sipas orarit të paraparë. (Grafikoni 3).




Grafikoni 3. Vlerësimi i procesit mësimor në Programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Frënge

Në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, gjithsej janë dhënë 41 vlerësime. Studentët të cilët i janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M=4.18$). Studentët kanë vlerësuar se gjatë ligjëratave janë të informuar në lidhje me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës ($M=4.32$), gjatë ushtrimeve niveli i informimit është pozitiv ($M=4.10$). Vlerësim pozitiv shprehet edhe për qartësinë e mësimdhënësve në ligjërata ($M=4.22$) kurse për orët e ushtrimeve niveli i qartësisë shprehet me ($M=3.85$) dhe se ka lidhshmëri të përmbajtjeve me përdorim praktik të njohuriv në ligjërata ($M=4.12$), kurse gjatë ushtrimeve ka tendencë uljes së nivelit të lidhshmërisë së përmbajtjeve me përdorim praktik ($M=3.85$). Studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M = 4.19$) dhe ushtrimeve ($M = 4.02$) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 4).




Grafikoni 4. Vlerësimi i procesit mësimor në Programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

Në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Maqedone, gjithsej janë dhënë 76 vlerësime. Studentët të cilët i janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar plotësisht nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M=4.69$). Studentët kanë vlerësuar se gjatë ligjëratave janë të informuar plotësisht në lidhje me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës, ($M=4.59$), gjatë ushtrimeve niveli i informimit është i lartë ($M=4.47$). Vlerësim pozitiv është shprehur edhe për qartësinë e mësimdhënësve në ligjërata ($M=4.50$) kurse për orët e ushtrimeve niveli i qartësisë shprehet me ($M=4.34$) dhe se ka lidhshmëri të përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive në ligjërata dhe ushtrime ($M=4.43$), ($M=4.29$). Studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M = 4.64$) dhe ushtrimeve ($M = 4.55$) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 5).



Grafikoni 5. Vlerësimi i procesit mësimor në Programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Maqedone

Në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, gjithsej janë dhënë 57 vlerësime. Studentët të cilët i janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar plotësisht nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M=4.73$). Studentët kanë vlerësuar se gjatë ligjëratave janë të informuar plotësisht në lidhje me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës, ($M=4.71$), gjatë ushtrimeve niveli i informimit ka qenë i lartë ($M=4.67$). Vlerësim pozitiv shprehet edhe për qartësinë e mësimdhënësve në ligjërata ($M=4.82$) kurse për orët e ushtrimeve niveli i qartësisë shprehet me ($M=4.74$) dhe se ka lidhshmëri të përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive në ligjërata dhe ushtrime ($M=4.84$), ($M=4.75$). Studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M = 4.74$) dhe ushtrimeve ($M = 4.61$) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 6). Nga këto të dhëna mund të konstatohet në këtë Program studimor të gjithë indikatorët tregojnë vlera të larta të vlerësimit nga ana e studentëve për të gjitha dukuritë e evaluuara.



Grafikoni 6. Vlerësimi i procesit mësimor në Programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

8. Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte

Fakulteti Filologjik si njësi e rëndësishme akademike e Universitetit të Tetovës, gjithmonë është përpjekur që të zhvillojë aktivitete të ndryshme në fushën e veprimtarisë shkencore-hulumtuese. Këtu bëhet fjalë për organizimin e konferencave me karakter kombëtar e ndërkombëtar, botimin e revistave të fakultetit, hartimin e projekteve hulumtuese të sferave të ndryshme për të plotësuar mungesat që egzistojnë.

Në përputhje me vendimin e Këshillit Mësimor-Shkencor të fakultetit, në vitin akademik 2018/2019, kjo njësi akademike i ka vënë detyrë vetes të ndjekë hapin e zhvillimit për të qenë krahas fakulteteve simotra këtu e më gjerë, njëkohësisht për të përmbushur nevojat që e bëjnë një fakultet të duket bashkëkohor, tërheqës e konkurrues për kohën në të cilën jetojmë.

Organizimi i konferencave shkencore me karakter kombëtar e ndërkombëtar tashmë është bërë traditë në Fakultetin Filologjik, dhe vlen të thuhet se falë mbajtjes së këtyre konferencave është shpeshuar edhe veprimtaria shkencore-botuese. Brenda aktiviteteve që organizohen nga Fakulteti Filologjik janë Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, si dhe Konferenca Ndërkombëtare Shkencore në të cilat ka diskutime dhe debate, si gjithmonë, tema me mjaft interes për gjuhën, letërsinë e kulturën shqiptare dhe atë të huaj. Pjesëmarrësit në konferencën e

Filologjikut, janë studiues të njohur shqiptarë nga vendi e jashtë për të dhënë kontributin e tyre në fushën e filologjisë në përgjithësi dhe albanologjisë në veçanti.

Punimet e konferencave dhe simpoziumeve të ndryshme shkencore në përgjithësi botohen si përmbledhje të veçanta. Kjo solli nevojën për themelimin e revistave shkencore të fakultetit. Në fillim, në kuadër të Filologjikut u botua revista „Cogito“, e cila përfshinte kryesisht përpjekjet e punës kërkimore shkencore të studiuesve të ndryshëm shqiptarë nga fusha të ndryshme albanologjike.

Ndërsa që nga viti 2014, Fakulteti Filologjik boton dy revista, Filologjia dhe Albanologjia, të dyja këto revista, nga dy herë në vit. Studiuesit janë të lirë të botojnë punime nga nënfusha të ndryshme të gjuhësisë dhe letërsisë, gjëra të cilat janë në hap me hulumtimet në rajon dhe më gjërë.

Revistës *Albanologjia* i paraprinë Seminari Albanologjik i cili tashmë vite me radhë po organizohet në kuadër të kësaj njësie akademike. Edhe në Seminarin Albanologjik marrin pjesë studiues të fushave të ndryshme albanologjike nga vendi dhe jashtë, për të thënë fjalën e fundit me prurjet e tyre më të reja shkencore. Botimi i revistës „Albanologjia“ është një tjetër hap tejet serioz që flet për afirmimin e vlerave shkencore albanologjike ndër shqiptarët, si dhe afirmuese e denjë e atyre vlerave të përbashkëta dhe të rëndësishme për gjuhën, letërsinë, etnografinë, historinë dhe mbarë kulturën e popujve që jetojnë në tërthoret gjeografike të Ballkanit e më gjerë. Revista ka karakter ndërkombëtar dhe shpresojmë që në të ardhmen të jetë konkurruese me revistat prestigjioze këtu dhe më gjerë.

Këto hulumtime e debate të hapura që po shtjellojnë studiuesit e sferave të ndryshme të kulturës gjatë konferencës, në bazë të planifikimit që ka bërë organizatori i konferencës, ndriçojnë sadopak atë që është preokupim yni i përbashkët. Me daljen në dritë të shumë çështjeve të panjohura, ose më pak të njohura nëpër këto konferenca, hapen shtigje të reja që na çojnë përpara, me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mësojmë sesi këto konkludime të nxjerra nga konferencat, duhet zbatuar në praktikë. Ky është tekefundit synimi ynë kryesor i organizimit të konferencave të tilla.

Përveç aktiviteteve të cilat në fokus e kanë veprimtarinë dhe hulumtimin e mësimdhënësve, as aktiviteti studentor nuk ka mbetur anësh. Studentët tanë të vyeshëm vazhdojnë të promovojnë dituritë dhe aftësitë e tyre përmes revistës së studentëve „Përtej“. Përfundimet dhe mesazhet e

rëndësishme të nxjerra nga këto hulumtime, sigurisht na ndihmojnë dukshëm edhe në procesin e mësimdhënies. Synimi ynë përfundimtar është nxjerrja e mësimëve pozitive nga këto konferenca, si dhe zbatimi praktik i ideve të reja të përfituara nga këto debate.

Fakulteti Filologjik ndër vite bashkëpunon me njësitë simotra akademike nga vendi dhe jashtë. Bashkëpunimi bëhet me qëllim të mobilizimit të stafit akademik për të realizuar projekte të përbashkëta me njësi akademike simotra. Kështu, në kuadër të Universitetit të Tetovës, fakulteti ynë ka ndihmuar në realizimin e konferencave shkencore me karakter ndërkombëtar në bashkëpunim edhe me universitete të tjera..

9. Hapësirat dhe resurset materiale

Të dhënat numerike të infrastrukturës dhe resurset materiale të Fakultetit Filologjik janë paraqitur në formë tabelare në tabelën 17 dhe 18.

Tabela 14. Hapësirat e Fakultetit Filologjik.

Nr.	Lloji i objektit	Njësitë	Sipërfaqja m ²
1.	Amfiteatër	2	344m ²
2.	Salla	12	747m ²
3.	Zyra	23	292m ²
4.	Hapësira administrative	8	257m ²
5.	Klasa kompjuterike	1	107m ²
Gjithsej		38	1.747m²

Tabela 15. Të dhënat materiale që disponon Fakulteti Filologjik.

Nr.	Lloji i pajisjes	Kuadri mësimor	Administrata	Biblioteka	Gjithsej
1.	Kompjuter	46	11	4	61
2.	LCD projektorë	10	/	/	10
3.	Skaner	10	2	1	13
4.	Printer	23	11	2	36
5.	Fotokopje	1	2	1	4

10. SWOT Analiza

<p>Pikat e forta</p> <p>Ofertë e gjerë e programeve studimore; Stafi i ri; Balancë gjinore e stafit akademik; Infrastrukturë bashkëkohore për realizimin mësim.</p>	<p>Pikat e dobëta</p> <p>Numër i vogël i bashkëpunëtorëve të rregullt; Mungesa e projektorëve në çdo klasë, dhe qasje në internet të fort që mësimdhënësi të ketë më shumë mundësi për menaxhim të orës.</p>
<p>Mundësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndryshimi i programeve në bazë të tregut të punës; ➤ Organizime ku studentët përdorin kapacitetin e tyre; ➤ Trajnime të stafit nga të huajt. 	<p>Rreziqet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Themelimi i institucioneve të shumta të arsimit të lartë në RMV; ➤ Rrënia e interesimit të studimit të gjuhëve, qoftë amtare apo të huaja; ➤ Rënia e numrit të studentëve për shkak të lëvizjes së popullsisë në vendet evropiane

Fakulteti Filologjik, ashtu si çdo fakultet tjetër ka anët e forta e të dobëta, mundësitë dhe pa diskutim rreziqet.

Ana e fortë e këtij fakulteti është pikërisht fakti që kemi disa programe studimore si mundësi për zgjedhje. Gjuhët, sidomos të huajat, janë asete që u nevojiten të rinjve për sukses dhe si një mënyrë për t'u lidhur me tregun e punës. Stafi i ri, shumica me moshë mesatare 40-45, moshë kjo e cila ka mundësi të ndjekë trendet botërore të mësimdhënies, duke e bërë mësimdhënien më atraktive dhe jo tipike tradicionale, gjë që zakonisht i karakterizon institucionet shtetërore në vendin tonë.

Mundësitë për përmirësim dhe avancim padiskutim që janë të shumta, por, me raste disa nga to mund të jetë të kushtëzuara nga faktorë të ndryshëm. Gjithsesi, parë në përgjithësi, avancim mund të llogaritet trajnimi i stafit nga mësimdhënësi të huaj me përvojë. Kjo mund të sjellë në përforsimin e raporteve ndërkolegiale, të cilat mund të rrisin edhe vullnetin për bashkëpunim më të thellë, gjithmonë për të mirën e përgjithshme. Përveç mësimdhënësve, edhe studentët duhet të ndjekin ligjerata nga profesorë të huaj eminent në fusha të caktuara, me qëllim që të involvohen më thellë brenda studimit të gjuhës që kanë zgjedhur.

Ndër rreziqet më të mëdha është ulja e numri të studentëve që regjistrohen. Kjo padiskutim që vjen si pasojë e faktorëve të jashtëm, por roli i faktorëve të brendshëm nuk duhet anashkaluar.

Faktori më me ndikim është migrimi masiv i rinisë jashtë vendit, por edhe rënia e natalitetit gjeneratë pas gjenerate sjell dukshëm uljen e numrit të studentëve. Fatkeqësisht, edhe ekzistenca e Universiteteve tjera e bën të mundur uljen e numrit të studentëve. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja është edhe ndryshimi i interesit të studentëve. Të rinjtë gjithnjë e më shumë duan të zgjedhin drejtime të cilat do të jenë më fitimprurëse për to, ndërsa drejtimet e gjuhëve i shohin si zakonisht drejtime të cilat i drejtojnë për në mësimdhënie. Kështu që, për t'i bërë ballë këtyre rreziqeve duhet të ofrohet cilësi e pakontestueshme, ambient motivues për studentët, mësimdhënës të përgatitur, trajnuar dhe motivuar për të dhënë më të mirën e tyre në sallën e mësimin. Kushtet fizike janë në dispozicion, por duhet të rritet motivimi i mësimdhënësve që ata të jenë pika e fortë e këtij fakulteti. Organizimi i eventeve të ndryshme duhet të inkurajohet, por edhe të përkrahen financiarisht nga rektorati.

11. Konkludimi

Si përfundim, mund të thuhet që Fakulteti Filologjik si njësi është munduar të japë maksimumin që të arrihen qëllimet. Normalisht, ashtu si edhe njeriu, edhe institucionet kanë hapësirë për ndryshim dhe përmirësim. Fakulteti Filologjik ka nevojë të pakontestueshme të rritjes së stafit të brendshëm, i cili është element i rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit arsimor.

Tetovë, më 10.04.2023